



R KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 16.12.2019

Dokument parlamentar

RAPORT PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR 2018 PËR PROJEKTIN “PROGRAMI PËR INFRASTRUKTURËN KOMUNALE V””

- ***Hyrje***

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, shqyrtoi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim financiar 2018 për projektin “Programi për infrastrukturën komunale V””, në mbledhjen e tij të datës 16 dhjetor 2019.

Komisioni caktoi relator për këtë projektligj Zotin Andrea MARTO.

Të pranishëm gjatë shqyrtimit të projektligjit ishin përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si dhe të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

- ***Baza kushtetuese e projektligjit***

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim financiar 2018 për projektin “Programi për infrastrukturën komunale V”” është nismë e Këshillit të Ministrave dhe i paraqitet për shqyrtim Kuvendit mbështetur në nenet 78, 83, pika 1, dhe 121 pika 1 të Kushtetutës.

Miratimi i këtij projektligji kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 3 e Rregullores së Kuvendit.

- ***Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit***

Projektligji në fjalë synon ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim financiar 2018 për projektin “Programi për infrastrukturën komunale V”.

“Programi për infrastrukturën komunale V” synon të kontribuojë në përmirësimin e sistemit të furnizimit me ujë dhe kanalizimet në bashkitë e përfshira në këtë projekt që janë ato të Lezhës, Fierit dhe Sarandës të cilat kanë qenë pjesë e fazave të mëparshme I dhe II të programit, Beratit, Kuçovës, Gjirokastrës, Kamzës dhe Lushnjes të cilat kanë qenë pjesë e fazave të mëparshme I, II, III e IV të programit.

“Programi për infrastrukturën komunale V” vjen si nevojë për investime për të përmbyllur investimet e kryera në fazat e mëparshme të programit dhe është paketa në vlerën më të madhe në këtë sektor, ndërsa vlera totale e investimeve në këtë program shkon deri në 130 milionë euro.

Programi në vetvete do të implementohet në dy faza ku:

- Faza 1 konsiston në planifikimin dhe specifikimin e investimeve nëpërmjet përditësimit dhe hartimit të studimeve të fizibilitetit. Në këtë fazë shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve do të mbështeten institucionalisht me qëllim forcimin e kapaciteteve dhe përmirësimin e performancës për të arritur kriteret e programit të vendosura si kusht paraprak për të proceduar me hapat e zbatimit të projektit. Kjo fazë e programit ka filluar në fillim të vitit 2019 dhe parashikohet të zgjasë rreth 12 muaj.
- Faza 2 konsiston në zbatimin në terren të investimeve të planifikuara nëpërmjet analizës së detajuar të studimeve të fizibilitetit. Shërbimet kryesore që do të kryhen gjatë kësaj faze konsistojnë në hartimin e projekteve të detajuara teknike, përgatitjen e dokumenteve të tenderimit të punimeve, si dhe kryerjen e mbikëqyrjen në terren të punimeve gjatë zbatimit të projekteve. Në këtë fazë Shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve do të marrin mbështetje institucionale të mëtejshme për të pasur operim të qëndrueshëm të investimeve, për të përmirësuar efikasitetin dhe për të lehtësuar zbatimin e planit të biznesit, planeve të operim-mirëmbajtjes, si dhe planit të ndryshimit të tarifave.

Marrëveshja në fjalë parashikon dakordësinë e dy qeverive për t’i mundësuar Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të marrë nga *KfW-ja*:

- një kredi të butë në vlerë të përgjithshme deri në 80 milionë euro;
- një kontribut financimi për masa të nevojshme shoqëruese deri në vlerën 3 milionë euro, për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të sipërpërmendur; si dhe
- një kontribut financimi në vlerë të përgjithshme deri në 6 milionë euro, i cili do të përdoret për investimin.

- ***Vlerësimi i Ligjshmërisë Kushtetuese dhe harmonizimi me legjislacionin në fuqi dhe aktet ndërkombëtare.***

Projektligji është në përputhje me nenet 78, 83, pika 1, dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, si dhe me ligjin nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Në aspektin procedural projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në aspektin formal projektligji përbëhet nga 2 nene.

- ***Vlerësimi i përputhshmërisë së projektligjit me Acquis Communautaire***

Ky projektligj nuk përaftron ndonjë legjislacion të BE-së.

- ***Efektet financiare të projektligjit***

Ky projekt është parashikuar në programin buxhetor afatmesëm 2019-2021 të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në programin “Ujësjellës-Kanalizime”.

- ***Diskutimi në komision***

Gjatë shqyrtimit të projektligjit relatori i projektligjit u shpreh se programi synon të kontribuojë në përmirësimin e në qëndrueshmërinë e aksesit që do të ketë popullsia e zonave të përfshira në program për ujin e pijshëm, për kanalizimet dhe pjesërisht trajtimin e ujerave të përdorura, për tarifa të pranueshme të kostove, si dhe në përmirësimin e performancës së shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve të bashkive të përfshira në program.

Përfaqësuesit e Ministrive paraqitën elementet kryesore të kësaj marrëveshjeje, si dhe iu përgjigjën deputetëve në lidhje me ecurinë e projektit dhe vazhdimin e tij, i cili do të realizohet me anë të këtij financimi.

Diskutimet në Komision, u përqëndruan kryesisht në:

- ecurinë e deritanishme të investimeve në fazat e mëparshme të këtij projekti, si dhe pjesën e investimit që shkon direkt në përmirësimin e infrastrukturës së furnizimit me ujë;
- termat financiarë që mund të kenë kreditë në kuadër të këtij programi;
- bashkitë që përfshihen në këtë program dhe tregues për ujësjellësa të veçantë që kanë përfituar deri tani;
- vlerësimin se sa nga këto shoqëri ujësjellësash që janë përzgjedhur si përfituese të mundshme do të jenë në gjendje të plotësojnë kushtet për të qenë përfituese; etj.

- ***Përfundim***

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni vlerësoi projektligjin për mundësimin e financimit të infrastrukturës në ujësjellë – kanalizime dhe përfitimeve që do të ketë popullsia e zonave të përfshira në program.

Komisioni e miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi me të gjitha votat e anëtarëve të pranishëm dhe u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare.

Andrea MARTO

Relator

Niko PELESHI

Kryetar